

**Data 14.10.2024**

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** : Inkubator i Biznesit në Mikpritje dhe Turizëm në Korçë, LOT 3: Pajisje.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 39150000-8

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 29,775,202.39 Lek pa TVSH Lek. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 301,368.44 Euro. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2023-2026. Programi 100 Fshatrat (100F) me kod projekti 18BN016.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 9*)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njepasnjeshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit..

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **jo** më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e larte monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin, natyrën, sasistë dhe vlerën e kontratës. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme për kontrata të ngjashme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë pajisjeve, mobiljeve në qendrën MIK. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat pajisjet dhe mobiljet që do të dorëzojnë do të jenë sipas specifikimeve teknike dhe projektit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe të marrin përsiper shërbimin e transportit, montimin, si dhe vendosjen nëpër vende të të gjitha pajisjeve, mobiljeve sipas projektit në qendrën MIK.. Dekolarata është dëshmi që vërteton marrjen e përgjegjesive nga operatorët ekonomikë dhe krijon një besueshmeri dhe siguri për autoritetin, për furnizimin dhe transportimin e mobiljeve, pajisjeve pranë qendrën MIK, në funksion të përmirësimit të infrastruktures vendore me qëllim përmirësimin e jetës së komunitetit që njesite vendore përfaqësojnë.

2.3.3 Operatori duhet të disponojë të paktën 2 mjete që nevojiten me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion	2	Pronësi ose me qira

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i mjetit janë vlerësuar të nevojshme, duke ju referuar natyrës dhe përmasat e kontrates, vendi ku do të dorëzohet malli, si dhe kohezgjatjes së furnizimit të tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që në momentin e dorëzimit, çdo mall të jetë sipas standardeve CE/ekuivalent dhe të plotësojnë respektivisht specifikimet e kërkuara.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi sipas standardeve.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është njw standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka si qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

*Shënim: Per zerat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund te ofertojnë ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*

-Përpara se të shpall njoftimin paraprakt të fituesit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë të huaj duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*Specifikimet teknike, preventivi me zerat e mallrave janë pjesë e pandare e DST.*